



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 177, datë 28.10.2022

PËR

**DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR.145, DATË 20.12.2021,**  
**TË KRYEMINISTRIT, “PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN**  
**E KOMITETIT SHUMËPALËSH MBI PARTNERITETIN**  
**PËR QEVERISJE TË HAPUR”**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të nenit 11, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr.145, datë 20.12.2021, të Kryeministrit, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- i. Emërtimi “Zëvendëskryemistri” zëvendësohet me “Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve”;
- ii. Nënndarja e pestë “- Ministrin përgjegjës për standardet dhe shërbimet;” hiqet.

b) Në pikën 10, emërtimi “Zëvendëskryeministrit” zëvendësohet me “Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve”.

2. Ngarkohen Komiteti Shumëpalësh dhe sekretariati për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**


**E D L R A M A**

NR.PROT. 5953  
DATE 31.10.2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT  
MINISTRIT TË SHTETIT PËR  
STANDARDET E SHËRBIMEVE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGAÇI**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjell Agaçi', written in a cursive style.